



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 45  
Prishtinë, 15 shtator 2009, në orën 11: 00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Gjylnaze Sylja, Fatmire Berisha, Bujar Bukoshi, Mimoza Ahmetaj, Qamile Morina dhe Nurishahe Hulaj.

Mungoi: Sllobodan Petroviq.

Të pranishëm: nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit - Shpresa Haxhijaj, administratore dhe Fatime Qorri, zyrtare ligjore, nga NDI-ja - Shefki Kastrati, nga OSBE-ja - Lejla Selimi dhe nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës - Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz - kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin nr. 02/1-36;
4. Të ndryshme.

*Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa ndryshime.*

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin nr. 02/1-36;**

**Sadik Idriz** – Projektligji për ndryshimin e Ligji për duhanin është miratuar nga Kuvendi në leximin e parë. Në këtë mbledhje Komisioni do ta formojë grupin e punës për amendamentimin e Ligjit. Propozoj që deputetja Nurishahe Hulaj të jetë kryesuese e grupit dhe dy të tjerë anëtarë.

Ju njoftoj se disa shoqata dhe organizata joqeveritare janë të interesuara për amendamentimin e Ligjit. Grupi i punës vendos se cilat shoqata do të ftohen dhe a duhet të mbahet dëgjim publik.

**Teuta Hadri** – Nuk pajtohet të organizohet dëgjim publik, sepse kur është miratuar Ligji i duhanit është organizuar dëgjimi publik. Tani në procedurë janë vetëm disa plotësime dhe ndryshime të domosdoshme të Ligjit të duhanit.

**Sadik Idriz** – Ligji i duhanit nuk është duke u zbatuar, prandaj nevojitet një sensibilizim i opinionit lidhur për të. Grupi i punës le ta vlerësojë a ka nevojë të organizohet dëgjim publik.

**Gjylnaze Sylja** – Propozoj që shoqatat dhe organizatat e interesuara t'i sjellin me shkrim vërejtjet e tyre për amendamentimin e Ligjit për duhanin.

**Rita Hajzeraj** - Propozoj të merren njoftime edhe nga ministritë përkatëse të përfshira në zbatimin e këtij ligji. Si do të bëhet zbatimi i Ligjit, nëse nuk janë ndarë mjetet e nevojshme buxhetore dhe nuk janë përfshirë shpenzimet për zbatimin e tij as në kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore.

**Nurishahe Hulaj** – I kam krahasuar pakot e cigareve të disa shteteve të rajonit dhe vërtetova se vetëm pakot e cigareve të Kosovës nuk kanë standarde të domosdoshme të parapara me ligj. Këto plotësime, amendamentet që do t'i bëjmë dhe një përkrahje më e madhe nga Qeveria, duhet të ndikojnë në zbatimin sa më të mirë të këtij ligji.

*Komisioni u pajtua që anëtarë të grupit të punës për amendamentimin e P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për duhanin të jenë:*

*Nurishahe Hulaj – kryesuese*

*Rita Hajzeraj – anëtare*

*Gjylnaze Sylja – anëtare*

### **4. Të ndryshme**

**Sadik Idriz** – Nga Qeveria i kemi marrë plotësimin dhe ndryshimin e strategjisë legislative për vitin 2009. Në fushëveprimin e Komisionit tonë kemi ndryshim dhe plotësim në dy projektligje të reja nga MPMS-ja, ndërsa nga Ministria e Shëndetësisë nuk kemi ndonjë ndryshim. MPMS-ja si plotësim të strategjisë do të sjellë dy projektligje, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-2 për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së dhe të familjeve të viktimave civile të luftës, si dhe Projektligjin për banim social. Propozoi të

plotësohet plani i punës me ligje të reja të parapara në plotësimin e strategjisë legislative dhe në mbledhjen e radhës të shqyrtohet plani i punës së Komisionit.

**Rita Hajzeraj** – I njoftoi anëtarët e Komisionit për takimin e kryetarëve të komisioneve me kryetarin e Kuvendit. Në takim është theksuar se Komisioni për Shëndetësi e ka realizuar planin e punës dhe nuk ka ngecje në amendamentimin e ligjeve, që janë në fushëveprimin e Komisionit. Komisioni gjithashtu e ka realizuar edhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Në këtë takim kam shprehur shqetësimin për ardhjen me vonesë në Kuvend të Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore dhe të Ligjit të Punës, të parapara edhe në strategjinë legislative të Qeverisë. Propozoj të kërkohen sqarime nga ministrinë përkatëse, pse nuk kanë arritur në Kuvend këto dy ligje sipas afatit të paraparë në strategjinë legislative?

Çështje tjetër që kam diskutuar në këtë takim ishin mjetet buxhetore, të ndara për Komisionin, në vlerë prej 10 mijë eurove të dedikuara për punën e Komisioni. Procedura e shpenzimit të këtyre mjeteve nuk ka qenë e qartë. Kam kërkuar që kjo procedurë të thjeshtësohet dhe këto mjete të përdoren për angazhimin e ekspertëve, për hulumtime dhe për udhëtime studimore të nevojshme për anëtarët e Komisionit. Sipas njoftimeve që morëm, mjetet e Komisionit, të cilat nuk janë shpenzuar deri më tani, nuk mund të shfrytëzohen nga Komisioni. Pjesa e mbetur në disponim të Komisionit është 3500 euro.

**Teuta Hadri** – Sipas njoftimeve që kam për Ligjin e sigurimeve shëndetësore, ky ligj fillimisht ka pasur kosto prej 150 milionë eurosh. Sipas studimeve të bëra, Ligji ka një kosto prej rreth 500 milionë eurosh. Këto shpenzime nuk mund të mbulohen dhe Ligji për shkak të koston së lartë nuk mund të dërgohet në Kuvend.

Edhe për amendamentimin e këtyre ligjeve, propozoj ta bëjmë edhe një vizitë studimore jashtë vendit.

**Sadik Idriz** – Mjetet e dedikuara për Komisionin nuk i kemi shpenzuar. Kemi diskutuar që këto mjete t'i shpenzojmë në një udhëtim studimor jashtë vendit, me ç'rast me ndonjë donator tjetër ta bëjmë një vizitë studimore, sidomos për Ligjin për sigurime shëndetësore dhe për Ligjin e punës. Nuk kemi pasur vendim se do të humbin këto mjete buxhetore, nëse nuk shpenzohen në pjesën e parë të vitit.

**Gjylnaze Sylja** – Propozoj të bëhet një kërkesë në Kryesi dhe të propozohet një plan i shpenzimit të këtyre mjeteve. Këto mjete le të shpenzohen për angazhimin e ekspertëve që do ta ndihmonin punën e Komisionit dhe për bashkëpunim me parlamentet e vendeve të tjera.

**Qamile Morina** – Propozoj që Komisioni t'i miratojë edhe procesverbalet e vizitave në terren dhe nga mbledhjet e Komisionit të ketë edhe transkripto në mënyrë që të rritet transparenca në Kuvend.

Komisioni i shëndetësisë të ftoj ekspertët e shoqatës „Fedrih Ebert Stiftung“ të na raportojnë për analizën e bërë lidhur me Ligjin e sigurimeve shëndetësore.

Komisioni i Shëndetësisë ka mbikëqyrur zbatimin e dy ligjeve në shëndetësi. Janë nxjerrë shumë rekomandime, por nuk janë zbatuar. Në këtë periudhë të vitit duhet ta mbikëqyrim edhe zbatimin e dy ligjeve: një nga lëmi i shëndetësisë dhe një nga lëmi i punës dhe i mirëqenies sociale.

Propozim tjetër kam edhe një shkresë, të përgatitur për Ministrin e Shëndetësisë, me komente ndaj shkresës së ministrit Alush Gashi, që ka të bëjë me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për veprimtarinë private në shëndetësi.

**Flora Brovina** – Propozoj që Komisioni t'i vizitojë nënat e të zhdukurve, të cilat ndodhen në grevë, t'i përkrahë kërkesat e tyre dhe të shohë se ç'mund të bëjë, meqë ai e ka bërë amendamentimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së dhe të familjeve të viktimave civile të luftës.

Komisioni i Shëndetësisë duhet të ketë edhe njoftime më të sakta për përhapjen e gripit të derrit në Kosovë. Propozoj që Komisioni të organizojë tryezë të rrumbullakët, në të cilën do të ftoheshin persona përgjegjës të Ministrisë së Shëndetësisë, të Ministrisë së Arsimit, të Ministrisë së Ambientit, të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, si dhe mediat që njoftohemi më saktë për përhapjen e sëmundjes dhe për masat parandaluese.

**Sadik Idriz** - Vizitën e nënave greviste mund ta realizojmë, por sa ka fuqi Komisioni të ndikojë në plotësimin e kërkesave të tyre? Mendoj se plotësimi i kërkesave të tyre është detyrim i Qeverisë dhe i EULEX-it.

**Rita Hajzeraj** – Pajtohem t'ua bëjmë një vizitë nënave të të zhdukurve, që ndodhen në grevë, por ne, si Komision, nuk kemi mundësi të ofrojmë ndonjë zgjidhje konkrete. Për këtë çështje kompetente janë organet e tjera.

**Gjylnaze Sylja** - Të gjithë e dimë se kërkesa e nënave është identifikimi i mbetjeve mortore. Sa jemi në gjendje t'u premtojmë se identifikimi i tyre do të bëhet brenda një kohe të caktuar. Kjo është përgjegjësi e institucioneve, por edhe e EULEX-it. Vizitën, në qoftë se bëhet, do ta konsideroja më tepër interesim të Komisionit për gjendjen shëndetësore të nënave, sepse jemi Komision i Shëndetësisë.

**Sadik Idriz** – Komisioni mund t'i vizitojë nënat greviste dhe të interesohet për shëndetin e tyre.

Përkritazi me shkresën e propozuar nga deputetja Qamile Morina, anëtarët e Komisionit, në mbledhjen e radhës mund ta shprehin qëndrimin e tyre për këto komente.

**Gjylnaze Sylja** – Propozoj që në shkresën e deputetes të fshihet fjalia „Komisioni kërkon sqarime shtesë për këto çështje”.

**Sadik Idriz** – Nga diskutimet që i kemi pasur me organizatën „Friedrich-Ebert-Stiftung” për hulumtimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore, kemi pritur që të arrijë në Kuvend dhe ta bëjmë edhe një vizitë pune në Slloveni.

**Mimoza Ahmeti** – Kam pasur një takim me përfaqësues të organizatës „Friedrich-Ebert-Stiftung”. Ata e kanë e përfunduar analizën për Ligjin për sigurime shëndetësore, ashtu siç është e rregulluar në disa shtete të rajonit. Mund ta bëjmë një takim dhe të paraqitet ajo analizë. Aty do të njoftohemi dhe të do të marrim informata si funksionojnë sigurimet shëndetësore në disa shtete të rajonit.

**Sadik Idriz** – Në mbledhjen e radhës mund ta ftojme përfaqësuesin e organizatës „Friedrich-Ebert-Stiftung” të na i paraqesë rezultatet e hulumtimit për Ligjin e sigurimeve shëndetësore.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 10

E hartoi  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

---

Sadik Idriz